



Udhezim Administrativ No.2000/3 Mbi zbatimin e Rregullores Per Vendosjen e Tatimit te Paragjykuar

Bashkekryesuesit e Autoritetit Qendror Fiskal,

Nxjerrin Udhezimin Administrativ te meposhtem:

Neni 1: Aktivitetet jofitimpruese

Ne kuptim te Seksionit 1/e te Rregullores Per Vendosjen e Tatimit te Paragjykuar, ne aktivitetet jofitimpruese, perfshihen:

- a)Aktivitetet qe kryhen nga cdo trup a pushtet administrativ qendror, rajonal dhe lokal.
- b)Aktivitetet e kryera nga cdo organizate, ekskluzivisht per qellime fetare, bamiresie, shkencore dhe edukative, me kushtin qe asnje pjese e fitimeve neto te mos perdoret per qellime te perfitimit personal te nje personi privat.
- c)Aktivitetet e kryera nga cdo organizate pune, oda ekonomike, organizata industriale apo bujqesore, me kushtin qe asnje pjese e fitimeve neto te mos perdoret per perfitimin e ndonje anetari individual apo aksioneri.

Cdo biznes qe kryhet nga organizatat e permendura ne pikat 1/a,b,c te ketij udhezimi, por qe nuk eshte i lidhur ne menyre thelbesore me qellimin primar te organizates, do te konsiderohet aktivitet per qellime fitimi.

Neni 2: Te ardhurat nga qerate

Ne zbatim te seksionit 3.2(a)(iii) te Rregullores Per vendosjen e Tatimit te Paragjykuar, cdo person qe fiton te ardhura nga qeraja e shtepive te banimit, zyrave a cdo pasurie tjeter te palujtshme, duhet te mbaje regjistrime te shkruara per te ardhurat e realizuara. Nese keto te ardhura jane me te ulta se 15,000 DM ne nje tremujor, atehere, nje deklarate duhet dorezuar dhe

kuota fikse e grupit te pare te bizneseve duhet paguar. Nese keto te ardhura jane me te larta se 15,000 DM ne nje tremujor, atehere, nje deklarate duhet dorezuar dhe pagesa e kuotes fikse dhe e 3 % te te ardhurave mbi 15,000DM duhet kryer.

Neni 3: Trajtimi i Bankave, Institucioneve Financiare, Agjencive te Udhetimit dhe Sherbimeve Financiare

Ne zbatim te Seksionit 4.2 te Rregullores per vendosjen e Tatimit te Paragjykuar, termi "te hyra bruto" per bankat dhe institucione te tjera financiare, nenkupton te ardhurat e realizuara nga:

- Interesat,
- Komisionet dhe tarifat bankare,
- Te ardhura te tjera operative

Per disa sherbime te tjera te vecanta si Agjente Udhetimesh, Agjente Turistike, Zyra Kembimi te Parave, Agjenci Transferimi Parash, si edhe cdo aktivitet tjeter te ngjashem, termi "te hyra bruto" nenkupton vetem sasine e te ardhurave te realizuara nga komisionet dhe tarifat qe ata arketojne per sherbimet qe kryejne.

Neni 4:Librat dhe regjistrimet per tatimpaguesit me nje xhiro me te ulet se 2,500 DM ne 3-mujor

Tatimpaguesit qe zhvillojne aktivitetin e tyre ne ambiente fikse dhe qe kane nje xhiro 3-mujore me te ulet se 2,500 DM, duhet te mbajne vetem nje liber arke ku te shenohet cdo dite nje permbledhje e shitjeve te tyre. Nje model i ketij libri jepet ketu me poshte:

No	Data/muaji/Viti	Shitjet ditore (DM)
(a)	(b)	(c)

Neni 5:Librat dhe regjistrimet per tatimpaguesit me nje xhiro 3-mujore ndermjet 2,500 dhe15,000 DM

Tatimpaguesit me nje xhiro 3-mujore ndermjet 2,500 dhe 15,000DM duhet te mbajne nje liber arke ku te regjistrohen te gjitha blerjet dhe shitjet e dites. Cdo blerje e regjistruar duhet te jete e argumentuar me nje fature a kupon. Vetem totali i shitjeve kerkohet te regjistrohet ne liber. Nje model i ketij libri jepet ketu me poshte:

No.	Data/muaji/Viti	Blerjet ditore	Shitjet ditore	Balanca ditore
(a)	(b)	(c)	(d)	(e)

Neni 6: Librat dhe regjistrimet per tatimpaguesit me nje xhiro 3-mujore me te larte se 15,000 DM

Tatimpaguesit me nje xhiro 3-mujore me te larte se 15,000 DM duhet te mbajne librat dhe regjistrimet e meposhtme:

Kupon numer

Emri i shitesit

TIN i shitesit

Adresa e shitesit

Pershkrimi i mallit/sherbimeve	Sasia	Cmimi	Totali
Totali.....			<input type="text"/>

Data/muaji/Viti

Nenshkrimi i personit pergjegjes

c) Nje liber shitje, ku te regjistrohen te gjitha faturat dhe kuponat e leshuar gjate muajit kerkohej te mbahet nga tatimpaguesi. Nje model i tij jepet ketu me poshte:

Faturat/kuponat e shitjes		Cmimi total i furnizimit	TIN i bleresit (nese ka)	Nenshkrimi dhe titulli i personit pergjegjes
Numer	Date			
1	2	3	4	5
Totali mujor:				

d) Nje liber blerjeje, ku te regjistrohen te gjitha faturat dhe kuponat e blerjeve, deklaratat e importit ne dogane si dhe cdo dokument tjeter i lidhur me importet, kerkohej te mbahet nga tatimpaguesi. Nje model i ketij libri jepet ketu me poshte:

Fatura/kupona blerje, Deklarata doganore		TIN i shitesit	Kosto totale e mallrave a shebimeve te blera	Nenshkrimi dhe titulli i personit pergjegjes
Date	Numer			
1	2	3	4	5

Neni 7: Ruajtja e regjistrimeve

Kopjet origjinale te dokumenteve te regjistruara ne librin e shitjeve dhe ne ate te blerjeve duhet te ruhen nga ana e tatimpaguesit per nje periudhe se paku tre vjecare.

Neni 8: Trajtimi i Hoteleve dhe Restoranteve- subjekte te Tatimit ne Sherbime

Ato tatimpagues qe jane subjekte te tatimit ne Sherbime, per qellime te atij tatimi do te vazhdojne te mbajne librat dhe regjistrimet qe u kerkon udhezimi administrativ perkates. Tatimi i Paragjykuar per to, do te llogaritet si vijon:

Shembull:

Marrim rastin e nje restoranti ne Prishtine me te dhenat e meposhtme:

- Xhiro 3 mujore: 45,000 DM

-Tatimi ne Sherbime: $45,000 \times 10\% = 4,500$ DM

-Zbresim Tatimin ne Sherbime nga xhiro 3 mujore: $45\ 000 - 4\ 500 = 40,500$ DM

-Baza e tatueshme me 3% tatim: $40,500 - 15,000 = 25,500$ DM

-Tatimi i paragjykuar per xhiron mbi 15,000DM: $25,500 \text{DM} \times 3\% = 765$ DM

-Kuota Fikse: 400 DM

-Tatimi total i Paragjykuar: $765 + 400 = 1165$ DM

Neni 9: Deklarata e Tatimit te Paragjykuar

Bazuar ne Seksionin 6.1, 6.2 dhe 6.3 te Rregullores per vendosjen e Tatimit te Paragjykuar, te gjithë tatimpaguesit, perfshi edhe kompanite e sigurimit, duhet te dorezojne cdo tre mujor nje deklarate para ose ne datat e specifikuara ne rregullore. Ne te njejten kohe, ata duhet te paguajne tatimin qe detyrohen ne nje nga zyrat e BPK-se. Nje model i deklarates tatimore per tatimin e paragjykuar jepet ketu me poshte dhe udhezimet se si duhet plotesuar deklarata do te printohen ne shpine te saj:

Deklarate e Tatimit te Paragjykuar

(Deklaroj nen pergjegjesine time se gjithcka ne kete deklarate eshte e vertete dhe ne perputhje me rregulloret ne fuqi)

1.1 Emri i tatimpaguesit		1.5 Periudha tatimore
1.2 TIN i tatimpaguesit		
1.3 Adresa e tatimpaguesit		1.6 Data/muaji/viti
1.4 Numri i telefonit te tatimpaguesit		

Bizneset me xhiro 3mujore me te ulet se DM 15,000 (Nese xhiro juaj eshte me e ulet se 15000DM ne 3mujor atehere vendos nje "x" mbi kutine e duhur qe te tregosh tatimin tend perfundimtar per ate 3mujor)

Lok.A Lok.B Lok.C

2.1.Biznese, sherbime, Profesionite, Zanatlinj	400	300	200
2.2.Aktivitate zbavitese	400	300	200
2.3.Transport	250	200	150
2.4.Tregtaret levizes dhe ato me te ardhura deri 2500 DM/3mujor	75	75	75

Bizneset me xhiro 3 mujore me te larte se DM 15,000

2.5.Te hyrat bruto per 3 mujorin _____	
2.6. Kufiri ndares =15,000 DM a quarter	
2.7 Nese 2.5>2.6 atehere (2.5-2.6)x 3%=tatimi per xhiron mbi 15,000DM ne 3 mujor _____	
2.8 Tatimi i Paragjykuar Total = Kuota Fikse sipas (2.1-2.4/a,b,c) + 2.7 _____	

Hotelet&Restorantet subjekte te Tatimit ne Sherbime


2.9 Te hyrat bruto per 3 mujorin _____	
2.10 Xhiro per qellime te Tatimit te Paragjykuar = 2.9 – Tatimin ne Sherbime _____	
2.11Baza e tatueshme= (Shuma ne kutine(2.10) minus 15,000DM _____	
2.12 Tatimi i Paragjykuar =(Shuma ne kutine 2.11 x 3%) +kuoten fikse sipas2.1/a,b,c _____	

Kompanite e Sigurimit

2.13 Totali i premieeve ne 3 mujor _____	
2.14 Shkalla Tatimore per Tatimin e Paragjykuar =10%	
2.15 Tatimi i Paragjykuar qe detyrohen (2.14x 2.13) _____	
2.15.Tatimi i paguar _____	

(Emri dhe nenshkrimi i personit pergjegjes) _____

(Nenshkrimi dhe vula e BPK)



Numri i llogarise

860 - 224

DM 1000	
DM 500	
DM 200	
DM 100	
DM 50	
DM 20	
DM 10	
DM 5	
DM 2	
DM 1	

TOTAL:

Neni 10: Bizneset qe fillojne dhe mbyllen gjate periudhes tatimore

Tatimpaguesve u kerkohet qe te deklarojne dhe te paguajne Tatimin e Paragjykuar edhe sikur te ushtrojne aktivitet qofte edhe per nje dite te vetme gjate 3 mujorit. Bizneset qe perfundimisht e mbyllin aktivitetin e tyre gjate 3 mujorit, duhet qe ne qoshen e djathte-larte, te deklarates tatimore te shkruajne fjalen “perfundimtare”.

Neni 11: Subjektet me me shume se nje vend biznesi

Bizneset qe kane disa dege a pika shitje, por qe kane te njejtin numer te regjistrimit te biznesit, do te paguajne vetem nje kuote fikse dhe vetem 3 % te xhiros se tyre te konsoliduar.

Neni 12: Hyrja ne fuqi

Ky Udhezim Administrativ hyn ne fuqi me 1 korrik 2000.

Bashkekryesuesi i
Autoritetit Qendror Fiskal

Ali SADRIU

Bashkekryesuesi i
Autoritetit Qendror Fiskal

Alan PEARSON

Instrukcion rreth menyres se plotesimit te Deklarates per Tatimin e Paragjykuar

Pjesa e pare

Kutia 1.1: Vendos emrin e tatimpaguesit. **Psh, "Albakos-trade"**

Kutia 1.2: Vendos NIT. **Psh, 3009167-1**

Kutia 1.3: Vendos adresen e biznesit. **Psh: Rruga "Nena Tereze" Nr.170, Prishtine**

Kutia 1.4: Vendos numrin e telefonit te biznesit/pronarit. **Psh, 277 89**

Kutia 1.5: Vendos periudhen tatimore. **Psh, 3m/3; 01.07.00-30.09.00**

Kutia 1.6: Vendos daten e deklarimit. **Psh, 10.10.00**

Pjesa e dyte

Bizneset me xhiro 3 mujore me te ulet se 15,000 DM

Kutia 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 a,b,c. Zgjidhni llojin e aktivitetit ekonomik qe ju zhvilloni ose ate qe eshte me i perafert me aktivitetin tuaj dhe vendndodhjen e biznesit dhe vendosni nje X ne kutine perkatese. Nese xhiro juaj 3 mujore eshte me e ulet se 15,000DM ky eshte tatimi juaj final per ate 3 mujor. Shkoni direkt tek rreshti 2.15.

Bizneset me xhiro 3 mujore me te larte se 15,000DM

Nese xhiro juaj 3 mujore eshte me e larte se 15,000DM atehere veproni si me poshte:

Kutia 2.5: Vendosni xhiron tuaj 3 mujore. **Psh 21,000DM**

Kutia 2.6: Kufiri ndares prej 15.000 DM xhiro ne 3 mujor

Kutia 2.7: Zbrisni 15,000DM nga shuma e plotesuar ne kutine 2.5 dhe rezultatin shumezoheni me 3%. **Psh 21000-15000=6000x 3%=180DM**

Kutia 2.8: Mblidhni rezultatin e 2.7 me kuoten fikse sipas 2.1-2.4 a,b,c. **Psh 180+400=580DM. Ky eshte tatimi juaj final per ate 3 mujor. Shkoni ne rreshtin 2.15**

Hotelet dhe restorantet subjekte te Tatimit ne Sherbime

Kutia 2.9: Vendos xhiron 3 mujore. **Psh 46,000DM**

Kutia 2.10: Zbrisni Tatimin ne Sherbime nga xhiro 3 mujore. **Psh, 46000-4600=41,400DM**

Kutia 2.11: Zbrisni 15,000DM nga rezultati ne kutine 2.10. **Psh, 41,400-15,000=26,400DM**

Kutia 2.12: Tatimi i Paragjykuar Total per ate 3 mujor eshte $26,400 \times 3\% = 792 + 400$ (kuota fikse) = 1192 DM

Kompanite e Sigurimit

Kutia 2.13: Plotesoni totalin e primeve per ate 3 mujor. **Psh: 2,123,009DM**

Kutia 2.14: Shumezoni shumen ne 2.13 me 10%. **Psh, 2,123,009 x 10% = 212,300 DM, i cili eshte tatimi qe kompania e sigurimit duhet te paguaje per ate 3 mujor.**

Tatimi i paguar

Kutia 2.15: Plotesoni tatimin e paragjykuar qe po paguani me kete deklarate

Pjesa e trete

Lereni pjesen e trete bosh per t'u plotesuar nga BPK

Kujdes!

- Dorezoni deklaraten ne nje nga filialet e BPK ne Prishtine, Mitrovice, Gjilan, Prizren, Peje, Ferizaj, Gjakove dhe cdo zyre tjeter te autorizuar per te pranuar pagesa tatimesh
- Kjo deklarate plotesohet ne 3 kopje mga te cilat kopjen 1 e merr Administrata Tatimore, kopja 2 i mbetet BPK dhe kopja 3 eshte per tatimpaguesin.
- Deklarata duhet dorezuar ne zyrat e permendura me lart jo me vone se data 15 tetor, 15 janar, 15 prill, 15 korrik per aktivitetin e kryer ne 3 mujorin paraardhes.
- Shkruani me germa kapitale te zeza ose te kalterta.